



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT

Adresa: Sheshi "4 Heronjte", Tel.033421212 Fax.033421201, www.vlora.gov.al; E-mail: info@vlora.gov.al

Nr. 4811 prot

Vlorë, 23.10 2015

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ datë _____ / _____ 2015

PËR

SAKTËSIMIN E KUFIJVE TË RRUGËS "MURAT TËRBAÇI" TË QYTETIT TË VLORËS

Mbështetur në ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore", neni 7 pika 2, neni 8 pika 1/VII gërma "b", neni 32 gërma II, i ndryshuar, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar) nenet 8, 121, 124 dhe 125, ligjin nr.9270, datë 29.07.2004 "Për sistemin e adresave" (i ndryshuar), nenit 3, VKB nr.47, datë 30.09.2003 "Për emërtimin e rrugëve", VKB nr.39, datë 07.11.2005 "Për emërtimin e bulevardeve, rrugëve, shesheve dhe parqeve ekzistues të paemërtuara", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Vlorë:

VENDOSI:

1. Segmenti rrugor "Akademia e Detarisë – vendi i quajtur "Lamanaj"" të emërtohet rruga "Vëllezërit Lamani" (sipas hartës hashkëlidhur këtij vendimi).
2. Segmenti rrugor "vendi i quajtur "Lamanaj" – sheshi "Wilson" të emërtohet rruga "Murat Tërbaçi" (sipas hartës bashkëlidhur këtij vendimi).
3. Në listën e emërtimit të rrugëve, shesheve e bulevardeve të qytetit të Vlorës të pasqyrohet ndryshimi i emërtimeve të paraqitura në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR


Dritan LELI

Drejtor i Dr. së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit
Erjon AMATAJ

Drejtor i Dr. Juridike
Daut ZERAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE

RELACION
mbi
PROJEKT-VENDIMIN

PËR
SAKTËSIMIN E KUFIJVE TË RRUGËS “MURAT TËRBAÇI” TË QYTETIT TË VLORËS

Të nderuar Këshilltarë.

Materiali që po ju paraqesim për diskutim dhe miratim mbështetet në ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore”, neni 7 pika 2, neni 8 pika 1/VII gërma “b”, neni 32 gërma II, i ndryshuar, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), nenet 8, 121, 124 dhe 125, ligjin nr.9270, datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave” (i ndryshuar), nenit 3, VKB nr.47, datë 30.09.2003 “Për emërtimin e rrugëve”, VKB nr.39, datë 07.11.2005 “Për emërtimin e bulevardeve, rrugëve, shesheve dhe parqeve ekzistues të paemërtuara”.

Me VKB nr.47, datë 30.09.2003 “Për emërtimin e rrugëve”, bashkëlidhur këtij materiali, segmenti rrugor “Akademia e Detarisë – vendi i quajtur “Lamanaj”” është emërtuar rruga “Vëllezërit Lamani”.

Ndërkohë, me VKB nr.39, datë 07.11.2005 “Për emërtimin e bulevardeve, rrugëve, shesheve dhe parqeve ekzistues të paemërtuara”, segmenti rrugor, i cili shtrihet në kufi me rrugën “Çamëria” nga njëra anë (veriu) dhe sheshin “Wilson” (jugu) nga ana tjetër, është emërtuar “Murat Tërbaçi”, duke përfshirë brenda tij edhe rrugën “Vëllezërit Lamani”.

Sa më sipër, nëpërmjet këtij projekt-vendimi kërkohet të rregullohet kjo pasaktësi:

1. duke kthyer legjitimitetin e VKB nr.47, datë 30.09.2003 “Për emërtimin e rrugëve”, përmes të cilit segmenti rrugor “Akademia e Detarisë – vendi i quajtur “Lamanaj”” është emërtuar rruga “Vëllezërit Lamani” dhe
2. saktësimi i kufizimeve të rrugës “Murat Tërbaçi”, duke përcaktuar nga njëra anë kufirin me rrugën “Vëllezërit Lamani” (veri) dhe sheshin “Wilson” (jugu) nga ana tjetër (sipas hartës bashkëlidhur)

Sa më sipër, kjo situatë paraqitet në hartën bashkëngjitur këtij projekt-vendimi, si pjesë e tij.

Drejtor i Dr. së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit
Erjon AMATAJ

Drejtor i Dr. Juridike
Daut ZERAJ



